



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:205670

Datë: 07.06.2023

Numri i dokumentit: 04372066

**P.nr.1199/22**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, në lëndën penale kundër të akuzuarve E.S., dhe E.K., të dytë nga Prizreni, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Kosovës, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1851-4/22 të datës 16.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në praninë e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi, të akuzuarit E.S., mbrojtësit të tij av. E.G., nga Prizreni, të akuzuarës E.K., më datë 27.04.2023, publikisht mori dhe shpalli këtë :

## A K T G J Y K I M

### Të akuzuarit:

**I. E.S.**, nga i ati ....., e ëma ....., e vajzërisë ....., i lindur më ....., në Prizren Rr “ .....” nr. ...., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion mekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, I martuar- bashkëjetesë, me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II. E.K.**, nga i ati ....., e ëma ....., e vajzërisë ....., e lindur më .....në Prizren, tani me vendbanim në fshatin ....., Komuna e Dragashit, ku të kryer shkollën fillore, e gjendjes së dobët ekonomike, e martuar- bashkëjetesë, me numër personal ....., shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

## I.

### ËSHTË FAJTOR

#### I akuzuari E.S.,

Me datë 18.09.2022 rreth orës 08:30 në Prizren, në shtëpinë e tyre te përbashkët, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin të dëmtuarës - viktimës së ndjeshme (bashkëshorten e tij) E.K., në atë mënyrë që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme midis tyre rreth punëve të shtëpisë dhe sjelljeve të së dëmtuarës, ditën kritike derisa të dytë ishin duke fjetur, aktivizohet alarmi i telefonit për zgjim nga gjumi, në atë moment i pandehuri kërkon nga e dëmtuara që të zgjohet për përgaditje të qajit, kurse e njëjta i përgjigjet ‘’edhe pak se herët është e diel sot’’, i pandehuri i revoltuar nga kjo përgjigje i thotë ‘’do të bëj video dhe do t’ia dërgoj nënës tënde ti tregoj se nuk po zgjohesh’’ dhe aty fillimisht e kap për flokë dhe për fyti, e më pas vazhdon ta godas me grushta në pjesë të ndryshme të trupit dhe i kërkon të largohet nga shtëpia, me ç’rast me këto veprime të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: gërvishje në regjionin e qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë), të konstatuara në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr.M.G., , me nr.të ref:Pz-526/22 të datës 22.10.2022.

**Këso dore ka kryer veprën penale: Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39 par 1 nën par 1.1, 40 par 1 nën par 1.3, 43, 69, 79, neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe neni 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të akuzuarin :

## G J Y K O N

#### Të akuzuarin E.S.,

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, me pëlqimin e të akuzuarit në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, Kodi nr. 06/L-074, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1200€ (njëmijë e dyqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në 6 gjasht) këste mujore dhe atë duke filluar nga data 01-05 të çdo muaji vijues, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro të gjobës do të llogaritet 1 (një) ditë burgim.

E dëmtuara E.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari **OBLIGOHET** që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 (njëzet) euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë

prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## II.

Në pajtim me neni 363 par.1 nën par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës 08/L-032, e akuzuara **E.K.,:**

### LIROHET NGA AKUZA

Me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin, të dëmtuarit (bashkëshortit të saj) E.S., në atë mënyrë që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme midis tyre ditën kritike derisa të dytë ishin duke fjetur, aktivizohet alarmi i telefonit për zgjim nga gjumi, në atë moment i dëmtuari kërkon nga e pandehura që të zgjohet për përgaditje të qajit, kurse e njëjta meqenëse ishte duke fjetur revoltohet nga kërkesa e të dëmtuarit dhe në atë moment fillon ta godas në qafë, e më pas largohet nga shtëpia, me ç'rast me këto veprime të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: mavijosje në pjesën e përparme të qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë), të konstatuara në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr.M.G., , me nr.të ref:Pz-526/22 të datës 22.10.2022.

**Kësodore kishte për të kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Pasi që nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penal për të cilën akuzohet.

Shpenzimet procedura bie në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me shenjën PP/II.nr.1851-4/22 të datës 16.11.2022, kundër të akuzuarve E.S., nga Prizreni dhe E.K., nga fshati B.ë, Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale, me datë 27.04.2023, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën kanë qenë prezent Prokurori i Shtetit Musli Gashi, i akuzuari E.S., dhe mbrojtësi i tij av. E.G., e akuzuara E.K., të cilët pas përfundimit të procedurës së provave, kanë vazhduar me fjalën përfundimtare.

**Prokurori i Shtetit Musli Gashi, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se:** ia dorëzon gjykatës fjalën përfundimtare me shkrim të përgatitur nga Prokurori i çështjes Beqë Shala dhe i propozon që e njëjta të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit.

Në fjalën përfundimtare me shkrim ka cekur se nga administrimi i provave në seancat gjyqësore të zhvilluara dhe nga faktet dhe provat tjera, është vërtetuar kjo gendje faktike se i pandehuri E.S., ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 1.3 të KP-së, si dhe e pandehura E.K., ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të KP-së të përshkruar si në dispozitave të aktakuzës, ku dhe ka mbetur në tërësi. Nga administrimi i provave të datës 24.02.2023, 23.03.2023, vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës. Deklarimi i dëshmitares G.S., në shqyrtim gjyqësor të datës 24.02.2022, deklarimi i dëshmitarit N.k., i datës 24.02.2022. Nga deklarimi i dëshmitares G.S., e njëjta ka deklaruar se fillimisht raportet në mes të pandehurve kanë qenë të mira, derisa e pandehura E.K., ka filluar të mos dëgjoj, duke mos e pyetur atë për vjehërr dhe djalin e saj – të pandehurin si bashkëshort. Ka deklaruar se ditën kritike ka dëgjuar djalin e saj E., duke bërë titur me zë “Mamë, babë a është E. në kuzhinë” dhe se ka vërejtur se i pandehuri ishte i gërrithur në qafë. Nga deklarimi i dëshmitarit N.k., i njëjti ka deklaruar se si e pandehura vajza e tij E.K., e ka thirrë në telefon dhe i ka treguar për rastin dhe se i njëjti menjëherë është nisur tek shtëpia e saj, mirëpo gjatë rrugës ka kuptuar se e njëjta ka qenë në Stacion Policor në Prizren. Nga mbrojtja e të pandehurit E.S., gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 23.03.2023, pos tjerash ka deklaruar se pas kësaj kërkesës së tij që e pandehura- bashkëshortja e tij, të përgatis çajin, e njëjta e ka goditur direkt në qafë me dorë dhe se në atë moment është vetëmbrojtur. Nga mbrojtja e të pandehurës E.K., në shqyrtim gjyqësor me datë 23.03.2023 e njëjta mohon të ketë goditur të pandehurin dhe se ka pas fjalosje në mes tyre, ndërsa pas fjalosjes i pandehuri E.S., e ka kapur për flokë dhe e ka grithur me duar në qafë dhe e ka goditur me grushta në pjesën të ndryshme të trupit dhe duke ju drejtuar me fjalë “hup sytë mos ti shohë” dhe se më pas ka shkuar drejt në polici. Deklarimet e të pandehurve janë në drejtim të shmangies së përgjegjësisë penale dhe në kundërshtim me faktet dhe provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Andaj, i ka propozuar që të pandehurin E.S., dhe E.K., për vepër penale me të cilën ngarkohet në aktakuzë të shpall fajtor dhe të dënohen sipas Ligjit.

**Mbrojtësi i të pandehurit E.S., – avokati E.G., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se:** pas administrimit të provave nga ana e gjykatës e sidomos të raporteve mjekësore nga eksperti mjeko-ligjor Dr. M.G., dhe pas konsultimeve me të mbrojturin e tij i njëjti e ka pranuar fajësinë mbi bazën vullnetare duke u penduar thëllë për veprimet e veta, duke i kërkuar falje për atë që ka ndodhur dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen do të përmbahet që mos të kryer asnjë lloj vepër penale, e gjitha kjo që ka ndodhur duhet t’ia lënë kohës së shkuar prandaj për këtë i ka propozuar si masë lehtësuese për caktimin dhe llojin e sanksionit penal, nga të lartcekurat i ka kërkuar që në rastin e shqiptimit të dënimit t’i shqiptoj një dënim sa më të butë duke pasur parasysh se i njëjti është penduar dhe në të ardhmen do të jetë i përmbajtur.

**I akuzuari E.S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se:** ka qëndruar në tërësi pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit të tij av. E.G., dhe i njëjti ka kërkuar falje për atë që kishte ndodhur në mes tij dhe ish bashkëshortes, duke shtuar se është penduar, premtonte se nuk do të përsërisë ndonjë veprim kundërligjor ndaj të njëjtës, jo vetëm ndaj saj por ndaj askujt, kjo ka qenë hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe kjo ka ndodhur nga momenti i çastit, e lut gjykatën që të ndaj tij të shqiptoj një dënim sa më të butë.

**E akuzuara E.K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se:** nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se nuk e ka gërvishur ish bashkëshortin e tij ashtu edhe siç ngarkohet, për këtë e thotë me përgjegjësi të plotë penale, pasi që ky rast ka ndodhur dy herë dhe nuk e ndien vetën fajtorë, duke u betuar para zotit që nuk e ka bërë këtë vepër duke e theksuar me përgjegjësi të plotë, andaj i propozon dhe lut gjykatës që të njëjtën ta liroj nga përgjegjësia penale, pasi që ka pasur dy herë dhunë nga kjo familje dhe duke shtuar se

nuk e ka grithur në qafë dhe se i akuzuari e ka shpif vet sepse ka shkuar në spital në ora 09:00 nga policia, ndërsa ish bashkëshorti i tij ka shkuar në ora 12:00 dhe i njëjti ka shkuar vet.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 27.04.2023, i akuzuari E.S., ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën i vihet në barrë sipas aktakuzës me shenjë PP/I.nr.1851-4/22 të datës 16.11.2022 edhe pse i njëjti është udhëzuar me të drejtat të cilat u takojnë sipas ligjit, pasi që i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti e ka pranuar fajësinë që iu ngarkohet me aktakuzë, këtë pranim gjykata e ka vërtetuar edhe nga provat materiale të cilat dalin nga shkresat e lëndës dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se me datë 18.09.2022 rreth orës 08:30 në Prizren, në shtëpinë e tyre te përbashkët, i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin të dëmtuarës- viktimës së ndjeshme (bashkëshorten e tij) E.K., në atë mënyrë që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme midis tyre rreth punëve të shtëpisë dhe sjelljeve të së dëmtuarës, ditën kritike derisa të dytë ishin duke fjetur, aktivizohet alarmi i telefonit për zgjim nga gjumi, në atë moment i pandehuri kërkon nga e dëmtuara që të zgjohet për përgaditje të qajit, kurse e njëjta i përgjigjet “edhe pak se herët është e diel sot”, i pandehuri i revoltuar nga kjo përgjigje i thotë “do të bëj video dhe do t’ia dërgoj nënës tënde ti tregoj se nuk po zgjohesh” dhe aty fillimisht e kap për flokë dhe për fyti, e më pas vazhdon ta godas me grushta në pjesë të ndryshme të trupit dhe i kërkon të largohet nga shtëpia, me ç’rast me këto veprime të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: dërmishje në regjionin e qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë), të konstatuara në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr.M.G., me nr.të ref:Pz-526/22 të datës 22.10.2022.

Andaj, gjykata në shqyrtim gjyqësor ka vazhduar me administrimin e provave materiale dhe personale të propozuara nga ana e prokurorit të shtetit, mbrojtësit të akuzuarit dhe të akuzuarës E.K., ashtu që janë dëgjuar dëshmitarët G.S., të dhënë në shqyrtimit gjyqësor më datë 24.02.2023, dëshmitari N.k., të dhënë në shqyrtim gjyqësor më datë 24.02.2023. Po ashtu janë lexuar dhe shikuar provat materiale dhe atë: deklaratat e të pandehurit E.S., të dhënë në prokurori të datës 11.10.2022 në cilësinë e të dëmtuarit më datë 07.11.2022, deklaratat e të pandehurës E.K., të dhënë në Prokurori më datë 07.11.2022 dhe atë në cilësinë e të dëmtuarës më datë 10.10.2022, raportet mjekësore të Spitalit Rajonal “Prim.Daut Mustafa” në Prizren, për të dëmtuarit: E.S., E. K. me nr.24162 dhe 24148 të datës 18.09.2022, akt-ekspertimi mjeko-ligjor Dr. M.G., me nr. Rev.526/2022 të datës 22.10.2022.

Po ashtu përveç provave materiale të administruara, gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitaren **G.a S.**, për vërtetimin në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, e njëjta është propozuar mbrojtësi i të akuzuarit E.S., avokat E.G., Dëshmitarja në deklaratën e saj ka deklaruar se djali i saj E. është njoftuar me vetë dëshirë me të akuzuarën E.K.,n, më pas të njëjtit janë fejuar dhe martuar sipas traditave. Në fillim, raportet e tyre bashkëshortore dhe familjare ishin të mira, por më vonë pas një viti kishin filluar të lindin mosmarrëveshjet në mes tyre, pasi që e akuzuara E.K., kishte filluar të mos dëgjoj, të mos pyet vjehrrën dhe bashkëshortin, e njëjta kishte filluar vazhdimisht të bashkëpunoj me prindërit e saj, kështu që prindi i saj e kishte marr vajzën pa pyetur fare dhe pa hyrë brenda në shtëpi tek ata. Të njëjtën e kishin marrë në mëngjes dhe e kishin kthyer në mbrëmje përsëri në shtëpi. E njëjta duke shtuar se ditën kritike ka qenë ditë pushimi e diel dhe se djali E. dhe E. kanë fjetur në katin e tretë të shtëpisë në dhomën e tyre të gjumit dhe pasi që ishte zgjuar nga gjumi në ora 09:30 në mëngjes me gjithë shokun e saj kanë zbritur poshtë në kuzhinë dhe kanë vërejtur se dyert e kuzhinës, korridorit dhe të oborrit kishin qenë të hapura, por kishte menduar se nusja ka zbritur poshtë në kuzhinë për të përgatitur çajin, mirëpo burri i saj i kishte thënë se nusja nuk është në kuzhinë, mirëpo e njëjta ka menduar se E.K., nuk është zgjuar ende prej gjumit dhe se kishte qenë ende në dhomën e fjetjes, por pas pak kishte dëgjuar djalin e saj E.n duke bërëtitur me zë “mamë, babë a është E. poshtë në kuzhinë” ne

i them jo, e kurë kishte zbritur djali poshtë në kuzhinë na tha se “në mëngjes është kërcënuar përmes telefonit nga babai i nuses”. Në momentin kurrë djali kishte shkuar poshtë në kuzhinë kishin vërejtur se ai ishte i grithur në qafë, më pas kanë kontrolluar dhomën e gjumit dhe kanë parë se mungon arri – dukati, por me E.K., nuk kanë kontaktuar, as me prindërit e saj, ndërkohë policia kishte thirre me telefon E.n S.n që të shkoj në stacion policor, dhe i kishin thënë që më pas të shkoj në Spital. Në ditën kritike nuk kishte dëgjuar asgjë se çka kishte ndodhur, por shton se të dytë kishin pasur mosmarrëveshje edhe më herët për shkak se E.K., ka shkuar në dhomë ku aty mbyllej dhe bisedonte me telefon. E njëjta ka theksuar se asnjëherë nuk i ka thirre prindërit e E.K., në telefon për ta sharrë atë. Ndërsa në ditën kritike nuk e kishte parë E., as duke qarë dhe as duke dalë nga shtëpia. Nuk e din arsyen se pse djali i saj E. ishte kërcënuar nga babai i E. dhe e njëjta ka shtuar se distanca në mes të dhomave të gjumit është diku 1,30 metra dhe dhomat i ndan një korridor, mirëpo e njëjta nuk kishte dëgjuar asgjë në ditën kritike, por gërvishtjen në qafën e djalit i kishte vërejtur pasi që kishte skuqje – grithje, ndërsa nuk kishte gjakderdhje. E njëjta në fund ka deklaruar se kurrë E. mbyllej në dhomë disa herë kishte shkuar për të thirre të njëjtën, mirëpo dera ka qenë çdo herë e mbyllur me çelës.

Po ashtu është dëgjuar edhe dëshmitari **N.k.**, i cili në deklaratën e tij ka theksuar se nuk ka qenë hera e parë që vajza e tij E.K., ka pësuar dhunë nga ish burri i saj, por herën e parë e njëjta kishte falur dhe përsëri vajza ishte kthyer në shtëpi tek burri i saj E.. Mirëpo, pas gjashtë muajve përsëri E.- ish burri i saj, kishte filluar të rrahë vajzën E. Kasami për një çaj. Në mëngjes diku rreth orës 08:30 minuta vajza – E.K., e kishte thirr nënën e saj në telefon dhe i kishte thënë se e ka rrah burri E. S., më tej i njëjti ka shtuar se e ka marrë veturën së bashku me djalin e tij M.in dhe prej fshatit B.ë janë nisur në drejtim të Prizrenit tek shtëpia e E.t S.t, por ndërkohë e kishte thirr E.K., në telefon dhe e kishte lajmëruar se është në Stacion Policor. Por kurrë i njëjti kishte shkuar në Stacion Policor, E. ishte dërguar në Spital dhe më pas e njëjta ishte kthyer përsëri. Në trupin e saj kishte parë gërvishtje në qafë të nximë, mavijosje, e cila i kishte thënë se e ka rrahë burri. Ndërsa E.n S. atë ditë nuk e kishte takuar, por të njëjtën e kishte thirr me telefon dhe e kishte sharë. I njëjti ka theksuar se vajza E., e ka thirre me telefon nënën e saj dhe e ka njoftuar se vazhdimisht ka pasur presion nga familja e burrit. Po ashtu E.K., edhe ditën kritike e ka njoftuar përmes të ëmën përmes telefonit. Pas përfundimit të procedurës në Polici së bashku me djalin dhe vajzën E. K. janë kthyer në shtëpi dhe më nuk kanë pasur kontakte me familjen e ish dhëndrit.

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka dëgjuar të akuzuarin **E.S.**, i cili në deponimin e tij ka deklaruar se në ditën e diel deri sa ishin duke fjetur në dhomën e gjumit me ish – bashkëshorten E., për një moment të njëjtën e kishte zgjuar nga gjumi dhe i kishte thënë “qu përgatite çajin” ndërsa E.K., pa i thënë asgjë e kishte goditur direk në qafë me dorë, shton se në atë moment i akuzuari E.S., ishte vetëmbrojtur, pasi që e kishte prekur vetëm me dorë për ta zgjuar nga gjumi, mirëpo e njëjta e kishte sulmuar, pas kësaj i njëjti ka vazhduar gjumin ndërsa e akuzuara (ish bashkëshortja) E.K., ka dalë nga dhoma e gjumit, ai deri sa kishte qenë duke fjetur kishte cingëruar telefoni rreth orës 10:14 min. Në këtë telefonat e kishte dëgjuar zërin e babait të ish bashkëshortes i cili kishte filluar të shaj disa herë, pas kësaj ka zbritur poshtë dhe ka pyetur nënën se “ku është E.”, ndërkohë kanë vërejtur se dyert e shtëpisë dhe të oborrit kishin qenë të hapura, por ndërkohë telefonon policia dhe kërkojnë që i njëjti të paraqitet në Stacion Policor. Pas deklaratës së dhënë në Stacion Policor, polici i kishte thënë “shko në spital dhe mere raportin mjekësor”. Pasi kishte marrë raportin i njëjti ka shkuar në shtëpi dhe ishte njoftuar nga nëna e tij se E.K., kishte marrë gjithë dukatin-arin, me vete, mirëpo të njëjtit nuk kanë tentuar që të pajtohet me të akuzuarën, i njëjti ka deklaruar se ka pasur lëndime në qafë, ngjarja kishte ndodhur në dhomën e gjumit, dhe asnjë anëtar i familjes nuk kishte dëgjuar për këtë ngjarje, pasi që ata kishin qenë në dhomën e tyre të gjumit, largësia –distanca mes dhomave

ka qenë 3-4 metra. Pasi që bashkëshorten e kishte zgjuar nga gjumi e njëjta e kishte sulmuar menjëherë, ndërsa më herët i kishin pasur raportet shumë të mira bashkëshortore, por me kalimin e kohës kishin filluar mosmarrëveshjet mes tyre.

E akuzuara **E.K.**, në mbrojtjen e saj ka deklaruar se ditën kritike nuk e kishte goditur ish bashkëshorti, mirëpo në mes tyre ka pasur fjalosje – mosmarrëveshje, pasi që kishte bërë alarmi në ora 08:00 të mëngjesit, pasi që e kishte ndaluar alarmin, ndërkohë ish bashkëshorti kishte kërkuar nga ajo që të qetë çaj, por e njëjta i kishte thënë se është e diel dhe se dëshiron të pushoj edhe pak, pas kësaj ish bashkëshorti e kap për flokë, e grithë në qafë me duar dhe e godet me grushta në pjesë të trupit. E njëjta kishte shkuar në dhomën e ndejës ku kishte telefonuar nënën e saj duke i treguar se “E. më ka rrahur”, më pas ka shkuar në dhomë të gjumit, mirëpo ish bashkëshorti i kishte thënë “hup sytë mos ti shoh” dhe në atë moment ishte veshur për të shkuar në polici, për arsye që babai i saj të mos shkojë në shtëpi të E.t për të bërë problem. Ndërsa prindërit e E.t kanë qenë në korridor dhe kanë dëgjuar ngjarjen. E njëjta ka deklaruar se për lëndimet e të akuzuarit E.S., në deklaratën e dhënë në prokurori të shtetit kishte thënë se “unë mendoj atë lëndime ia ka shkaktuar nëna e vet vetëm e vetëm që ta arsyetoj që goditjet që më i ka bërë mua i ka bërë në vetëmbrojtje “, sepse i njëjti ka pasur kohë të bëjë çka të dojë. Duke shtuar se çdo herë alarmi i saj kishte bërë në ora 08:00 në mëngjes për tu zgjuar, pasi që e njëjta ka pasur frikë dhe presion nga familjarët e të akuzuarit E.S.,. E njëjta ka theksuar se shkaku dhe arsyeja për çka e kishte goditur ish bashkëshorti ishte nxitja e bërë nga nëna e tij, dhe gjithmonë i njëjti kishte treguar agresivitet në dhomë duke i ushtruar dhunë dhe duke i thënë se “ti veç punët e shtëpisë ki me i bo”, ndërsa arsyeja tjetër ka qenë pse nuk kishte qitë çaj ditën kritike. Po ashtu e njëjta në deklaratën e saj ka shtuar se ditën kritike pasi që kishte shkuar në dhomë me fytyrë të enjtur duke qarë i kishte marrë gjësendet e veta, ndërsa ish bashkëshorti duke qëndruar i shtrirë në shtrat i kishte thënë “pak është kjo që ta kam bërë është dashur edhe më shumë me të bë se ti nuk mbushesh mend dhe i kishte thënë hup se sytë nuk du me ti pa”. E njëjta ka deklaruar se ka pasur kërcënime të vazhdueshme.

Gjykata duke e analizuar provat dhe lidhshmërinë e provave në tërësi, sa i përket të akuzuarës E.K., pas administrimit të provave gjykata nuk ka mundur të vërtetoj se e njëjta me çfarëdo veprimi të ketë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 pika 3.1 të KPK-së, me ç’rast gjykata në mungesë të provave në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPPK, të njëjtën e liroi nga akti akuzues. Kjo për faktin se gjatë administrimit të provave të propozuara nga ana e prokurorit të shtetit me veprimet e akuzuarës nuk ndërlihen elementet e veprës penale në veprimet konkrete. Pra gjatë ditës kritike si rezultat i mosmarrëveshjeve midis tyre deri sa ishin duke fjetur, aktivizohet alarmi i telefonit për zgjim në atë moment i akuzuari kërkon nga e akuzuara që të zgjohet për përgatitje të qajit, kurse e njëjta meqenëse ishte duke fjetur i përgjigjet “edhe pak se herët është e diel sot”, i akuzuari i revoltuar e godet me grushta në pjesë të ndryshme të trupit dhe i kërkon të largohet nga shtëpia, me ç’rast me këto veprime të akuzuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore, ku kjo gjendje e këtuillë faktike është vërtetuar me pranimin e fajësisë nga vet i akuzuari si në dispozitivin nën **I./** të këtij aktgjykimi.

Vlen të theksohet se në rastin konkret gjykata pas administrimit të provave materiale të cilat janë pjesë e aktakuzës, pas vlerësimit të përshkrimit faktik dhe cilësimit juridik të veprës penale dhe atë lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me par.1 pika 3.1 të KPK-së. Gjykata edhe pse ka administruar provën materiale dhe atë: raporti mjekësor i Spitalit Rajonal me numër 24162 të datës 18.09.2022 për të akuzuarin E.S., ku përmes kësaj prove në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor të Dr.M.G., janë konstatuar lëndime të lehta trupore dhe atë: mavijosje në pjesën e përparme të qafës, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të

mprehtë), mirëpo këto lëndime trupore kundër të akuzuarit E.S., nuk është provuar me asnjë provë tjetër materiale dhe personale se nga kush janë shkaktuar. Pasi që për të konsideruar kryerja e kësaj vepre penale krahas ekspertizës si provë materiale duhet të vërtetohet edhe me ndonjë provë tjetër relevantë veprimet kundërligjore të akuzuarës E.K., nëkryerjen e veprës penale për të cilën i vihet në barrë sipas aktit akuzues.

Po ashtu për vërtetimin e plotë dhe të gjendjes së plotë faktike gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitë e dëshmitares **G.a S.**, ku gjykata ia ka falur besimin pjesërisht dhe atë në deklarimin e dhënë në shqyrtimin gjyqësor e cila ka theksuar për raportet e tyre që në fillim kanë qenë të mira dhe pastaj janë keqësuar për këtë nuk e kanë mohuar as të akuzuarit dhe për këtë gjykata ia fali besimin. Ndërsa për deklaratimet në lidhje me ngjarjen e cila ka theksuar se pas ditës kritike e sidomos pasi që djali i saj i akuzuari kishte zbritur poshtë në kuzhinë dëshmitarja e kishte vërejtur se i akuzuari E.S., ishte i grithur në qafë, për këtë pjesë të deklaratës të dhënë gjykata nuk ia fali besimin, për faktin se e njëjta nuk e ka parë ngjarjen, pasi që me vetë ka deklaruar se “Në ditën kritike nuk kishte dëgjuar asgjë se çka kishte ndodhur”, pasi që vet fakti që kanë pasur raporte të acaruar nuk nënkupton që e akuzuara ka përdorur dhunën fizike ndaj të akuzuarit E.S.,. Po ashtu gjykata ka dëgjuar edhe deklaratën e dëshmitarit **N.K.**, , gjykata ia ka falur besimin deklaratimeve të dëshmitarit, pasi që këto vërtetohet edhe me deklaratat e të akuzuarve, pasi që i njëjti e ka përshkruar ngjarjen në mënyrë kronologjike duke shpjeguar raportet e mëhershme të akuzuarve dhe më pastaj ngjarjen pas ditës kritike se si e akuzuara e kishte thirr nënën e saj dhe dëshmitari së bashku me djalin e tij që ishin nisur në drejtim të qytetit për ta marr të akuzuarën E.K.,. Gjkata nuk ka arritur të vërtetoj ndonjë fakt me rëndësi për këtë çështje penale duke u nisur nga fakti se ditën kritike i njëjti nuk ka qenë prezent në vendin e ngjarjes, andaj nuk mund të vërtetohet fakti që e akuzuara të ketë shkaktuar lëndime trupore ndaj ish bashkëshortit të saj.

Gjkata po ashtu ka dëgjuar dëshminë e të akuzuarit **E.S.**,, i cili ka deklaruar se në ditën e diel deri sa ishin duke fjetur në dhomën e gjumit me ish – bashkëshorten E., për një moment të njëjtën e kishte zgjuar nga gjumi dhe i kishte thënë “qu përgatite çajin” ndërsa E.K., pa i thënë asgjë e kishte goditur direk në qafë me dorë, shton se në atë moment i akuzuari E.S., ishte vetëmbrojtur, pasi që e kishte prekur vetëm me dorë për ta zgjuar nga gjumi, mirëpo e njëjta e kishte sulmuar, pas kësaj i njëjti ka vazhduar gjumin. Gjkata për këtë pjesë të deklaratës nuk mund të ia fal besimin, pasi që i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale si në dispozitivin nën **I**, arsyeja e mos faljes së besimit është nga fakti se i njëjti e ka goditur të akuzuarën E.K.,, po ashtu i njëjti nuk ka ndërmarr veprime për t’u vetëmbrojtur pasi që e ka sulmuar të akuzuarën, pasi që pas ngjarjes i njëjti ka vazhduar me gjumin.

Po ashtu gjykata ia fal besimin mbrojtjes së të akuzuarës **E.K.**,, pasi që e njëjta në ditën kritike nuk e kishte goditur ish bashkëshorti, mirëpo në mes tyre ka pasur fjalosje – mosmarrëveshje, pasi që kishte bërë alarmi në ora 08:00 të mëngjesit, që e kishte ndalur alarmin, ndërkohë ish bashkëshorti kishte kërkuar nga ajo që të qetë çaj, por e njëjta i kishte thënë se është e diel dhe se dëshiron të pushoj edhe pak, pas kësaj ish bashkëshorti e kap për flokë, e grithë në qafë me duar dhe e godet me grushta në pjesë të trupit. E njëjta kishte shkuar në dhomën e ndejës ku kishte telefonuar nënën e saj duke i treguar se “E. më ka rrahur”, më pas ka shkuar në dhomë të gjumit, mirëpo ish bashkëshorti i kishte thënë “hup sytë mos ti shoh” dhe në atë moment ishte veshur për të shkuar në polici, për arsye që babai i saj të mos shkojë në shtëpi të E.t për të bërë problem.

Gjkata pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave personale dhe materiale për të akuzuarën E.K., të cilat gjenden në shkresat e lëndës, një nga një dhe të gjitha së bashku në lidhje me provat tjera dhe në baze të vlerësimit të tyre, ka nxjerrë përfundimin se me asnjë provë



nuk është provuar se e akuzuara të ketë kryer veprën penale të Lëndimit të lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh se për tu kryer vepra penale e Lëndimit të lehtë trupor kërkohet një minimim i mjekimit apo të përkujdesjes, si lëndim i lehtë trupor konsiderohet rasti kur shkaktohet shenja në integritetin trupor apo dhimbje fizike të kohëzgjatjes së shkurtër. Në rastin konkret është shkaktuar lëndimi trupor ndaj të akuzuarit E.S., mirëpo mungon lidhja shkak –pasojë sepse nuk është vërtetuar se lëndimet trupore të akuzuarit E.S., janë shkaktuar nga e akuzuara E.K.,.

Në të vërtetë, gjykata gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor, në veprimet e të akuzuarës E.K., nuk ka mundur të gjejë asnjë element të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 3 lidhur me par 1 pika 3.1 të KPK-së dhe nga të gjitha këto veprime, nuk janë realizuar elementet e vepër penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar, për të akuzuarit E.S., pranimin e fajësisë, kërkim faljen, pendimin dhe gjendjen e tij të dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese është marrë natyra dhe lloji i veprës penale, rrezikshmërinë e veprës penale, dhe se vepra penale është kryer ndaj viktimës së ndjeshme- ish bashkëshortes, Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i këtij dënimi, i cili sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuarit dhe se shqiptimi i dënimit të tillë do të ndikojë që të akuzuarit të përmbahen nga veprimet kundërligjore në të ardhmën.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në pajtim me nenin 451 dhe 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me nenin 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:205670, 27.04.2023**

**G j y q t a r i**

---

Gani Kastrati

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjet) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.